

FORMULARI I TERMAVE TE REFERENCËS DHE PROJEKT - IDEA**“RIKONSTRUKSION, MODERNIZIM I REPARTEVE / MAGAZINAVE TE HSH”****HYRJE.****PARATHËNIE.**

Ky dokument “Termat e References”, hartohet me qëllim për të Orientuar OE ne marrjen e masave inxhinierike për venien ne funksion te repartit te riparimit te lokomotivave te NJSHML. Dokumenti jep nje ide, për të mundësuar, hartimin e projektit dhe preventivit final të objektit **“RIKONSTRUKSION, MODERNIZIM I REPARTEVE / MAGAZINAVE TE HSH”**, Reparti riparimit te lokomotivave.

SITUATA EKZISTUESE

Reparti i riparimit te lokomotivave strukture e ndertuar me themele me plinta beton arme, kollona b/a dopio T dhe mbulimin me soleta b/a te parapergatitura ne nyje prodhuese. Kollonat jane te ndertuara me vuta per aresye te vendosjes se trareve te betonit mbi te cilat jane montuar shinat per levizjen e vinc-ures.

Profili i repartit eshte tipi repart industrial per te realizuar sherbime teknike te riparimit te lokomotivave. Ky repart eshte i ndertuar me tre kanale betoni mbi te cilat jane montuar shinat per levizjen e mjeteve hekurudhore.

Gjate termetit te Nentorit te vitit 2019 ky repart pesoi demtime si ne strukturen b/a ashtu dhe ne muraturen veshese prej tulle. Muratura e tulles eshte e ndertuar jashte kollonave te struktures dhe pa lidhje me breza betoni gje e cila ka cuar ne demtimin e mureve perimetrale.



Fig. Reparti i riparimit te lokomotivave

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE TË REPARTIT

Reparti i riparimit te lokomotivave është i pozicionuar prane territorit te Njesise Sherbimit te Mjeteve Levizese ne Lagjen nr.13 Pazh Durres.



Fig.2: Ortofoto Reparti i riparimit te lokomotivave

Reparti eshte me gjatesi 83.4 ml dhe gjeresi 26.6 ml. Lartesia e repartit eshte 10.35 m.
Reparti eshte vene ne shfrytezim ne vitet 70.

Distanca midis kollonave eshte afersisht 6m.

Kollonat beton arme jane me seksion terthor dopio ti deri ne pjesen e vutes qe sherben per vendosjen e trareve dhe pastaj vazhdojne me seksion drejtkendor.

Kollonat jane te inkastruara ne plinta betoni te cilat jane te lidhur me njeri-tjetrin me trare lidhes. Mbi traret e betonit te montuar mbi vute eshte montuar vinc-ura e cila sherben per ngritjen e peshave te renda me kapacitet 10 ton.

Mbulimi i repartit eshte me soleta beton arme te derdhura ne poligone prodhuese te para viteve 90 dhe te lidhura me njera tjetren sipas kushtit teknik.

Soleta nga vezhgimi vizual nuk duket te kete demtime por duhet te behet kontrolli teknik me aparaturat e posacme.

Traret lidhes midis kollonave dhe vete kollonat kane pesuar demtime nga termeti dhe duhet te behet perforcimi i tyre me projektues te licensuar dhe te sigurohet qendrueshmeria e objektit si dhe ndertime te reja ne pjese te caktuara te repartit.

Kollonat e struktures kane pesuar demtime serioze te betonit sidomos ne shtresen mbrojtese te betonit dhe ka dalje dhe demtime serioze te armatures se hekurit si (ndryshkje, keputje te hekurit, zvogelim i trashesise se dimensionit te hekurit nga ndryshkja, deformime te ndryshme). Per kete aresyje duhet te behet kontrolli i aftesise mbajtese te kollonave beton arme me aparatura te posacme (marka e betonit, qendrueshmeria e objektit ne fazen aktuale) dhe me tej te paraqitet nga konstruktori projekti konstruktiv i perfocimit te struktures dhe sigurimin e aftesise mbajtese

te objektit ne gjendje normale dhe gjate vendosjes ne pune te dy vinxhave me ngarkese dhe pa ngarkese te cilat i japin goditje dinamike dhe vibruese struktures.

Gjithashtu duhet te behet kontrolli i qendrueshmerise se plintave te gjithë struktures dhe nese eshte e nevojshme duhet te behet rirforcimi i tyre sipas projektit qe do te hartojë konstruktori dhe te siguroje aftesine mbajtese te struktures ne gjendje te lire dhe ne gjendjen kur vehet ne levizje te dy vinxhat me ngarkese dhe pa ngarkese te cilat i japin goditje dinamike dhe vibruese struktures.







FUSHE VEPRIMI I PUNËS SE KONTRAKTORIT.

Hekurudha Shqiptare Sh.a lagja nr.3 Rruga "Egnatia", Tel. 052 222 037 email: www.hsh.com.al

1. Kontraktori duhet të paraqesë:
 - 1.1. Projektin e zbatimit dhe preventivin përkatës, për venien në funksion të repartit riparimit lokomotivave duke:
 - a. Përcaktuar me saktësi kontrollin teknik të strukturave mbajtëse si kollona, trare, soleta me mjetet përkatëse si dhe sigurimin dhe përgjegjësinë për qëndrueshmërinë dhe aftësinë mbajtëse të objektit para dhe pas ndertimit.
 - b. Zgjidhja e duhur teknike dhe llogaritja e duhur inxhinierike për forcimin e strukturave mbajtëse b/a me masa inxhinierike të cilat konsistojnë në forcimin e kollonave mbajtëse dhe trareve lidhës midis kollonave.
2. Kontraktori duhet të vendosi nëse objekti (themelet, kollona, traret soleta, muratura, traret e vinxhurave) janë statikisht të qëndrueshëm në gjendjen aktuale duke kryer të gjitha analizat laboratorike dhe kontrollet e nevojshme dhe me përgjegjësinë e plote të vendosi në baze të analizave dhe kontrolleve të duhura nëse objekti mund të rikonstruktohet duke mbajtur përgjegjësinë e plote për çdo dëmtim që i ndodh strukturës mbas konstruktimit dhe gjatë venjes në punë të vinxhave me ngarkesë ose pa ngarkesë si dhe hyrjen dhe daljen e lokomotivave të cilat japin goditje vibruese dinamike.
3. Komisioni teknik për hartimin e dokumentacionit le të përgjegjësi të plote të kontraktorit rezultatet e analizave, zhvillimin e projektit, kontrollet, ndertimin, aftësinë mbajtëse dhe qëndrueshmërinë e objektit para dhe mbas rikonstruktimit dhe vendosjes në punë.

PROJEKTI I ZBATIMIT

HARTIMI I PROJEKTIT TË ZBATIMIT NGA KONTRAKTORI DUHET TË PËRFSHIJË :

Hartimin e projektit dhe preventivit përfundimtar të objektit.

1. Projektin dhe preventivin e punimeve konstruktive për forcimin e strukturave b/a (Plinta Kollona, Trare).
2. Preventivin e punimeve, pastrime, punime prishjeje etj, që do të kryhen në objekt.
3. Projektin dhe preventivin, për punime ndertimi mure perimetrale me breza (arkitrare) antisizmik .
4. Projektin dhe preventivin e punimeve, për punimet e shtresave të betonit + hekuru në dyshemene të repartit.
5. Projektin dhe preventivin e punimeve, ndertimin e reparteve ndihmes të cilat janë dëmtuar.
6. Projektin dhe preventivin e punimeve, për dyer , dritare reparti.
7. Projektin dhe preventivin për vendosjen e vinxhës 10 ton.
8. Projektin dhe preventivin e punimeve të hidroizolimit të repartit dhe kullimit të ujërave të shiut.


9. Projektin dhe preventivin e punimeve te riparimeve te linjes levizjes mjeteve brenda repartit.
10. Projektin dhe preventivin e punimeve per sistemin KUZ dhe KUB per dhomat e punes se mekanikeve.
11. Projektin dhe preventivin e punimeve elektrike instalime te reja te tipit per reparte pune industriale.

Punimet ndërtimore, por pa u kufizuar, per realizimin e projektit konsistojne ne:

1. Percaktimi dhe mbledhja e masave per te prodhuar specifikimet e projektit duke perdorur kontributin e dhene nga specialiste te fushes.
2. Pergatitja e preventivit te detajuar sipas specifikimeve te projektit me programin e punimeve te ndare sipas kategorive dhe zerave te punes.
3. Harmonizimi dhe kordinimi i kategorive te punes se projektit te bere nga specialistet e perfshire ne planikikimin e projektit.


Paraqitja e projektit ne forme grafike me te gjitha detajet e nevojshme per zbatim duhet te jene ne shkallen 1:50.

PLANIMETRIA E REPARTIT



PRERJE TERTHORE E REPARTIT

PRERJA A-A



DOKUMENTACIONI TEKNIK

Operatori ekonomik gjithë materialin e projektit duhet ta dorëzojë (ne CD) ne PDF versionet finale dhe ne formatin origjinal te punuar, kompatibel me programet AutoCAD, Word, Exel brënda 30 ditësh nga data e lidhjes së kontratës dhe i dorëzohet për miratim autoritetit kontaktor.

Bazuar në llogaritjet edhe vizatimet e projektit, Operatori ekonomik do të hartojë një listë me të gjitha zërat e punimeve që janë pjese perberese e Listës Përfundimtare të Volumeve (Preventiv). Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe menyren e llogaritjes se tyre. Cmimet do te jene sipas analizave teknike ne fuqi. Zërat e punimeve që nuk janë parashikuar në këtë listë çmimesh njësi të miratuar, konsulenti do t'i shoqërojë me analizen e llogaritjes se çmimit.

Zbatimi i projektit nuk mund të tejkaloj periudhën prej 5 muaj nga data e njoftimit të fillimit të punimeve.

Projekti me të gjitha raportet e kërkuara do të dorëzohet në formë të printuar në 5 (pesë) kopje në shqip të firmosura në origjinal dhe në formatet e kërkuar.

Garancia e punimeve, në vlerën prej 5% të preventivit, do të rikthehet operatorit ekonomik fitues 2 vite pas kolaudit të punimeve.

Kontraktori duhet te deklaroje garancine, jetegjatesise dhe qendrueshmerine e objektit me projektin qe do te hartoje dhe do te realizoje.